



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
GRUPI PARLAMENTAR "DEMOKRAT"

Nr. _____ Prot. _____

Tiranë, më ____ . ____ .2020

Lënda : Propozim projektligji: "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, dt. 29.12.2008", "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;

Drejtuar : KRYETARIT TË KUVENDIT

Z. GRAMOZ RUÇI

I nderuar Z. Kryetar,

Bazuar në nenin 71, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e deputetes të Kuvendit të Shqipërisë, po depozitoj pranë Jush, për shqyrtim dhe miratim pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore, projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, dt. 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;

Ky projektligj synon ndryshime në Kodin Zgjedhor, me qëllim verifikimin e figurave publike, duke synuar transparencë, besueshmëri dhe kandidatë me figurë të pastër morale në zgjedhjet e përgjithshme dhe ato vendore.

Bashkëngjitur propozimit dhe relacioni përkatës.

Duke ju falenderuar,

DEPUTETE

RUDINA HAJDARI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I POSAÇËM PËR REFORMËN ZGJEDHORE

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2020

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10019, DT. 29.12.2008, “KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet, mbi verifikimin e figurave të pastërtisë së kandidatëve për t’u zgjedhur deputet apo kryetar bashkie, sipas nenit 30 të ligjit 45/2015, në lidhje me ekzistencën të informacioneve në dokumente të ish-sigurimit të shtetit, si më poshtë vijon:

Neni 67

1.Në pikën 1, në përfundim të fjalisë së paragrafit të parë, të shtohet fjalia:

“si dhe kërkesën me gjeneralitetet e partisë politike të regjistruar në zgjedhje, për verifikimin e figurave të kandidatëve për deputet në çdo zonë zgjedhore, e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati që konkuron për t’u zgjedhur deputet në zonën zgjedhore përkatëse.

2.Në pikën 2, në përfundim të fjalisë së paragrafit të dytë, të shtohet një paragraf tjetër me këtë përmbajtje:

“Partia politike e regjistruar për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, depoziton në KZAZ që mbulon njësinë e qeverisjes vendore përkatëse, kërkesën për verifikimin e figurës së kandidatit për kryetar bashkie, ku janë të shënuara edhe gjeneralitetet e partisë politike, e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar

dhe i nënshkruar nga vetë kandidati që konkuron për t'u zgjedhur kryetar bashkie në zonën zgjedhore përkatëse”.

3. Në pikën 2, në përfundim të fjalisë së paragrafit të parë, të shtohet fjalia:

“si dhe kërkesën për verifikimin e kandidatëve me gjeneralitetet e partisë politike pjesëtare të koalicionit, e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati që konkuron për t'u zgjedhur deputet për çdo zonë zgjedhore.

4. Në pikën 3, në përfundim të fjalisë së paragrafit të parë, të shtohet fjalët me këtë përmbajtje:

“si dhe depoziton në KQZ kërkesën për verifikimin e figurës së kandidatit të saj, ku janë të shënuara edhe gjeneralitetet e partisë politike, e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati që konkuron për t'u zgjedhur kryetar bashkie në zonën zgjedhore përkatëse”.

Neni 69

Pas pikës 4 të Nenit 69, të shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

Komiteti nismëtar i regjistruar në KQZ për zgjedhjet për Kuvend, jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve, ka detyrimin t'i paraqesë KQZ-së:

- a) kërkesën për verifikimin e figurës së kandidatit për deputet, me qëllim vlerësimin e ekzistencës së rrethanave, sipas nenit 30 të ligjit 45/2015, “Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”,
- b) kërkesa e komitetit nismëtar, e cila përmban gjeneralitetet e 9 zgjedhësve nga zona zgjedhore përkatëse, duhet të jetë e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati që konkuron për t'u zgjedhur deputet në zonën zgjedhore përkatëse.

Neni 70

Pas pikës 4 të Nenit 70, të shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

Komiteti nismëtar i regjistruar në KZAA, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve, ka detyrimin t'i paraqesë KZAA-së përkatëse:

- a) kërkesën për verifikimin e figurës së kandidatit për kryetar bashkie, me qëllim vlerësimin e ekzistencës së rrethanave, sipas nenit 30 të ligjit 45/2015, “Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”,
- b) kërkesa e komitetit nismëtar, e cila përmban gjeneralitetet e 9 zgjedhësve nga zona zgjedhore përkatëse, duhet të jetë e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati që konkuron për t'u zgjedhur kryetar bashkie në zonën zgjedhore përkatëse.

Neni 72

Pas pikës 2, gërma d) të këtij neni të shtohet gërma dh) me këtë përmbajtje:

dh) deklarin e kandidatit dhe nënshkrimin e tij në një formular vetëdeklarimi, ku duhet të deklarojë mosekzistencën e informacioneve në dokumente të ish- sigurimit të shtetit për të, sipas parashikimeve të përcaktuara në pikën 2 të Nenit 30 të ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit.....”.

Neni 73

1.Në pikën 2, pas përfundimit të fjalisë, të shtohet fjalia si më poshtë:

“Mosparaqitja e kërkesës për verifikimin e figurës së kandidatëve për tu zgjedhur deputet apo kryetarë bashkie nga çdo subjekt zgjedhor, lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish- sigurimit të shtetit, e shoqëruar kjo me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati që konkuron për tu zgjedhur deputet apo kryetar bashkie në zonën zgjedhore përkatëse, sipas zgjedhjeve të radhës, përbën shkak për marrjen e vendimit për refuzimin e dokumentacionit përfundimtar.

2. Të shtohet pika 7 në Nenin 73, me këtë përmbajtje:

KQZ-ja ose, sipas rastit KZAZ-ja, me disponimin e kërkesës së paraqitur nga çdo subjekt zgjedhor, për verifikimin e figurës së kandidatëve që konkurojnë për deputet apo për kryetar bashkie, e shoqëruar me formularin tip të aplikimit të plotësuar nga vetë kandidatin për t’u zgjedhur, menjëherë e dërgon atë pranë Autoritetit, për të kryer procedurat e vlerësimit të figurës së pastërtisë së çdo kandidati, në lidhje me ekzistencën për ta, të informacioneve në dokumente të ish-sigurimit të shtetit,

6. Autoriteti, me administrimin e kërkesës të dërguar nga KQZ/KZAZ, e shoqëruar me formularët tip të aplikimit të plotësuar nga vetë kandidati për t’u zgjedhur deputet apo kryetar bashkie, pas shqyrtimit të kërkesës, verifikimit të plotë, do të shprehet me vendim për rezultatet e verifikimit, lidhur me ekzistencën për ta, të informacioneve në dokumente të ish-sigurimit të shtetit, të cilin menjëherë i’a përcjellë KQZ dhe vetë subjektit zgjedhor kërkues, por jo më vonë se dy muaj pas disponimit të kërkesës.

Pas Nenit 73, të shtohet neni 73/1, me këtë përmbajtje:

Veprimet e KQZ-së, në rastin kur për kandidatin për t’u zgjedhur deputet apo kryetar bashkie, figurojnë të këtë informacione në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas pikës 2 të Nenit 30 të ligjit 45/2015.

1.Kur KQZ njihet me vendimmarrjen e Autoritetit, për kandidatin që konkuron për t’u zgjedhur deputet apo kryetar bashkie dhe për të cilin ekzistojnë informacioneve në dokumente të ish-sigurimit të shtetit, sipas parashikimeve të pikës 2, të Nenit 30, të ligjit 45/2015, kryen veprimet e mëposhtme:

a) heq emrin e kandidatit para procesit të shtypjes së fletëve të votimit dhe në rastin e kandidatit për kryetar bashkie nuk e zëvendëson atë, kur informacionin e disponon para kryerjes së këtij procesi.

b) shpall pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore përkatëse, kur kandidati ka të drejtën e mandatit të kryetarit të bashkisë, mbi bazën e votave të marra, si dhe faktin e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë së kandidatit përkatës, kur informacionin e disponon pas shtypjes së fletëve të votimit dhe para shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve,

c) shpall fitues nga lista shumemërore kandidatin vijues në renditje dhe në përputhje me kuotën gjinore, si dhe shpall faktin e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë për kandidatin përkatës, kur informacionin e disponon pas shtypjes së fletëve të votimit dhe para shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve,

d) shpall pavlefshmërinë e mandatit ndaj personit i shpallur i zgjedhur në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, si dhe shpall mandatin, në përputhje me Kodin Zgjedhor, kur informacionin e disponon pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve.



Neni 82

Të shtohet një paragraf tjetër tek Neni 82 me këtë përmbajtje:

KQZ brenda këtij minutazhi duhet:

- a) së pari, të informojë zgjedhësit, për rezultatit e verifikimit të kryer nga Autoriteti, mbi ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish- Sigurimit të Shtetit, për çdo kandidat që konkuron në zgjedhjet e radhës, i propozuar nga subjekti zgjedhor përkatës,
- b) Së dyti, duhet të publikojë në media dhe në faqen zyrtare të saj në internet, vendimet e Autoritetit mbi rezultatet e verifikimit të figurës së pastërtisë të çdo kandidati për t'u zgjedhur objekt verifikimi.

RELACION

Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10019, dt. 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për transparencën e fushatës zgjedhore, verifikimi i figurave të pastërtisë së kandidatëve për deputet apo kryetar bashkie.

Në kuadër të vlerësimit të figurës së pastërtisë sipas legjislacionit përkatës (ligji 45/2015, “Për të drejtën e informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”) të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për deputet apo kandidatëve për kryetar bashkie, për qëllime të transparencës së figurës së tyre gjatë fushatave elektorale, është e nevojshme ndërhyrja në dispozita të veçanta të legjislacionit zgjedhor, duke bërë amendimet e duhura.

Për më tepër, nga praktika e krijuar në dy zgjedhjet elektorale të fundit të zhvilluara përkatësisht në Qershor 2017 (zgjedhjet parlamentare) dhe në Qershor 2019 (zgjedhjet vendore), është vërejtur se partitë politike të regjistruara në zgjedhje dhe këtu kam parasysh partitë e mëdha politike parlamentare dhe ato jashtë Parlamentit si PS, PD, LSI, etj., nuk kanë paraqitur kërkesë pranë Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në lidhje me ekzistencën e informacioneve në dokumentet e ish –Sigurimit të Shtetit për kandidatët për deputet apo kryetar bashkie, në zbatim të nenit 30 të ligjit 45/2015 me të cilin ushtron veprimtarinë e vet ky Autoritet.

Ky proces verifikimi i figurës së pastërtisë së kandidatëve për deputet apo kryetar bashkie, ka nevojë të disiplinohet në dispozita të veçanta të Kodit Zgjedhor, për të cilat mund të ketë disa alternativa:

-Fillimin e procesit paraprak të verifikimit të figurës së pastërtisë të kandidaturave për deputet apo kryetar bashkie, ku së bashku me dokumentacionin e regjistrimit të partive politike në zgjedhje, të sillen dhe kandidaturat potenciale për tu zgjedhur deputetë apo kryetar bashkie (jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve), së bashku edhe formularët e aplikimit të plotësuar nga vetë kandidati për t’u verifikuar për pastërtinë e figurës.

-Fillimin e procesit të verifikimit të figurave të pastërtisë së kandidaturave për deputet apo kryetar bashkie, në afatin kohor të paraqitjes së listës shumëemërore të kandidatëve për çdo zonë zgjedhore, 50 ditë para datës së zgjedhjeve, ku subjektet politike duhet të sjellin edhe formularët e aplikimit të plotësuar nga vetë kandidati për t’u verifikuar për pastërtinë e figurës.

-Verifikimi i figurës së pastërtisë të kandidatëve për deputet apo kryetar bashkie, ku vetë kandidati duhet të plotësojë formularin e aplikimit dhe të vetëdeklarojë (varianti polak, ku nëse vetëdeklarimi është i rremë çështja dërgohet në gjykatën kompetente), nëse është në kushtet e parashikimeve të nenit 30 të ligjit 45/2017, variant ky nëse vërehet ekzistenca e kushteve ka penalitetet e duhura.

Në këtë kontekst, është e nevojshme, t'i propozoj Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore bërjen e disa shtesave dhe ndryshimeve ligjore të domosdoshme, në funksion të transparencës së fushatës zgjedhore, ku çdo zgjedhës gjatë fushatës elektorale të informohet lidhur me rezultatin e verifikimit të figurës së pastërtisë për kandidatin që do të votojë sipas llojit të zgjedhjeve, duke shmangur apo minimizuar futjen në Parlament apo si drejtues bashkie kandidatë për të cilët ekzistojnë dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit deri në Korrik të vitit 1991 (këtu mund të përmenden kriteret e Nenit 30, pika 2 të ligjit 45/2015).

The logo for 'exit news' is centered on the page. It consists of the word 'exit' in a bold, lowercase, sans-serif font, with a small dot above the 'i'. Below it, the word 'news' is written in a smaller, lowercase, sans-serif font. The entire logo is enclosed within a thin, grey rectangular border.